



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 91-të, të mbajtur më 31.08.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Lënda me numër 12-3970/1 të datës 11.08.2023, **HIDHET POSHT.**

Denoncimi I dorëzuar të dorëzohet për veprim kompetent në Ministrinë e punëve të brendshme të RMV-së.

Lënda me numër 12-3970/1 të datës 11.08.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-3970/1 datë 11.08.2023 është formuar në bazë të denoncimit së dorëzuar nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve për keqpërdorime financiare gjatë transportit të drurit në ///. KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Krahas denoncimit është dorëzuar edhe një dëshmi – fotokopje e fletë dorëzimit.

Pas këqyrjes së përmbajtjes së denoncimit dhe provave të dorëzuara, KSHPK-ja vlerësoi se lënda nuk ka elemente për veprim kompetent. Autoriteti kompetent që mund të hetojë pretendimet nga raporti është Ministria e Punëve të Brendshme e RMV-së, për të cilën denoncimi i dorëzuar me provat do t'i përcillet këtij organi për veprim kompetent.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv.

Dorëzuar:
- Parashtruesi
- Ministria e punëve të mbrendshme të RMV-së

Përgatiti: Mr. D.D
Miratoi: Mr. SH.S

KOMISIONI SHTETËROR

PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar,
Sofka Pejovska Dojçinovska

